



MANUAL

I PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN VENDIMMARRËS TË KUVENDIT

2022



MANUAL

I PJESEMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN VENDIMMARRËS TË KUVENDIT

“Miratuar nga Byroja e Kuvendit me Vendim Nr. 20, datë 20.05.2022”

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Kapitulli I	
ÇËSHITJE TË PËRGJITHSHME	8
1. Objekti, qëllimi dhe fusha e veprimit	
2 Parimet e pjesëmarrjes	
3.Format e pjesëmarrjes	
4. Palët e interesuara	
Kapitulli II	
VEPRIMTARIA E KUVENDIT	10
2.1. Agjenda parlamentare	
2.2. Organet e Kuvendit	
2.3. Deputeti dhe publiku	
2.4. Mjetet dhe platforma	
2.4.1. Programi i transparencës	
2.4.2. Kërkesa për informim	
2.4.3. Kuvendi, publiku dhe media	
2.4.4. Aplikacioni mobile “Kuvendi i Shqipërisë”	
Kapitulli III	
BASHKËPUNIMI I KUVENDIT ME PUBLIKUN	14
3.1. Propozimi i nismave legjislative	
3.2.Seancat dëgjimore	
3.2.1. Seancat dëgjimore në procesin legjislativ	
3.2.2. Seancat dëgjimore, kontroll parlamentar	
3.2.3. Seancat dëgjimore, procesi zgjedhës	
3.2.4. . Kërkesa dhe koordinimi për pjesëmarrje	
3.3. Platforma e konsultimit <i>online</i> të projektligjeve	
Kapitulli IV	
KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PUBLIKU	17
Kapitulli V	
PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VEPRIMTARI TË TJERA	18
5.1. Pjesëmarrja e publikut në Kuvend	
5.2. Vizitat në Kuvend dhe pjesëmarrja në programet e edukimit qytetar	
5.3. Raporti periodik dhe konferenca vjetore	

Kapitulli VI	
REGJISTRAT DHE FORMULARËT	20
6.1 Regjistri për shoqërinë civile	
6.2 Regjistri për lobistë	
6.3 Regjistri për petitionet	
6.4 Regjistri i kërkesave për informacion	
Shtojca	
SHPJEGUES I TERMINOLOGJISË SË MANUALIT	21

■ Hyrje

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është organi më i lartë përfaqësues në vend. Përfaqësimi nënkupton delegimin e interesave, në këtë rast interesave politike, të cilat shprehen me anë të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe periodike.

Përfaqësimi politik realizohet nëpërmjet funksionit legjislativ, kontrollues dhe zgjedhor.

Bashkëpunimi i institucionit të Kuvendit me publikun, në të gjitha format e tij, është i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm ndaj për këtë qëllim Kuvendi ka ndërmarrë një sërë masash, përfshirë edhe rastet e jashtëzakonshme, ndërveprimi me publikun për të siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri.

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje është element thelbësor për çdo sistem politik transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik. Pjesëmarrja në veprimtarinë e Kuvendit e sjell publikun më pranë përfaqësuesve të tyre, krijon mundësinë që ata të adresojnë probleme e të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për to, të analizojnë e vlerësojnë rezultatet e zbatimit të politikave, si dhe të mbikëqyrin veprimtarinë e të zgjedhurve të tyre. Ajo merr rëndësi të veçantë kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me grupe në nevojë, si: personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, minoritetet, etj.

Në vitin 2014 për herë të parë është miratuar “Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit”, si instrument në shërbim të publikut, për të rritur pjesëmarrjen e tij.

Nevoja e rishikimit vjen pas një periudhe prej 8 vitesh implementimi të manualit, për shkak të ndryshimeve e përmirësimeve në strukturë dhe infrastrukturë të Kuvendit dhe veprimtarisë së tij, si: digjitalizimi, propozimeve të ardhura nga konsultimi me shoqërinë civile të raporteve vjetore “Për Pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit”, problematikave të hasura në bashkëpunimin me publikun, etj.

Ky manual i ofron publikut mundësinë që, duke filluar nga qytetari më i thjeshtë e deri te palët e interesuara, të shndërrohet në pjesëmarrës aktiv të procesit vendimmarrës të kuvendit si edhe të përmirësimit të politikave në shërbim të tij.

Manuali i rishikuar ka reflektuar të gjitha ndryshimet e bëra gjatë procesit të gjatë të konsultimit, me të gjitha palët në proces të cilat konsistojnë në: strukturë dhe përmbajtje.

Manuali është i ndarë në gjashtë kapituj kryesorë ku, Kapitulli i parë trajton çështje të përgjithshme, Kapitulli i dytë pasqyron veprimtarinë e Kuvendit, Kapitulli i tretë paraqet bashkëpunimin e Kuvendit me publikun, Kapitulli i katërt jep informacion për Këshillin Kombëtar të Integritetit dhe publikun, Kapitulli i pestë përshkruan pjesëmarrjen e publikut në veprimtari të tjera dhe Kapitulli i gjashtë përmban regjistrat dhe formularët për pjesëmarrje.

Rishikimi i Manualit është bërë me mbështetjen e OSBE-së.

Kapitulli I

■ ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Në këtë kapitull trajtohen çështje të përgjithshme si objekti i manualit, qëllimi, fusha e veprimit, parimet dhe format e pjesëmarrjes në kuptimin e trajtuar në këtë manual, për një qartësi në kuptimin e terminologjisë së përdorur

1. Objekti, qëllimi dhe fusha e veprimit

Objekti i manualit është informimi, shpjegimi dhe thjeshtësimi i procedurave të pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit në ushtrim të funksioneve të tij.

Qëllimi i manualit është nxitja e pjesëmarrjes së publikut dhe rritja e bashkëpunimit në veprimtarinë e Kuvendit për të siguruar vendimmarrjen e mirëinformuar dhe gjithëpërfshirëse.

Fusha e veprimit të manualit është procesi i shqyrtimit të çështjeve sipas funksioneve të Kuvendit në interes të palëve të interesuara.

2. Parimet e pjesëmarrjes

Parimet e pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit janë:¹

Ligjshmëria - respektimi i Kushtetutës, i ligjeve dhe i akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Reciprociteti - respektimi i pozicionit të palëve gjatë procesit të bashkëpunimit.

Transparenca, hapja dhe akses - qasja në kohë e publikut në veprimtarinë dhe dokumentacionin parlamentar publik, sipas legjislacionit në fuqi.²

Paanësia - publiku në të gjitha format e organizimit të tij vepron në mënyrë të pavarur dhe mbron pozicione të ndryshme.

Përgjegjshmëria dhe efikasiteti - pjesëmarrja orientohet drejt rezultateve e me ndikim në përmbajtje dhe autoritetet janë të përgjegjshme përpara publikut në proceset e konsultimit dhe në raportin mbi rezultatet.

Mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë dhe gjithëpërfshirja - qasja e barabartë në procesin e pjesëmarrjes, përfshirë adresimin e nevojave të pakicave, grupeve të marginalizuara të pafavorizuara, që dëshirojnë të marrin pjesë.

Pavarësia - publiku, në të gjitha format e organizimit të tij, angazhohet në procese vendimmarrëse ose mbron pozicione të caktuara, të pandikuara.

3. Format e pjesëmarrjes

Pjesëmarrja e publikut në veprimtarinë e Kuvendit realizohet nëpërmjet disa formave, të cilat janë:

• Informimi

Informimi është forma më e thjeshtë aktive e pjesëmarrjes së publikut. Kuvendi informon publikun për veprimtarinë e tij, si dhe i siguron informacionin mbi të cilin publiku është i interesuar.

• Konsultimi³

Konsultimi është procesi i marrjes së mendimit të publikut nga ana e Kuvendit në ushtrim të

¹ Rekomandimet për rritjen e pjesëmarrjes së shoqatave në proceset e vendimeve publike nga pjesëmarrësit në forumin e OJQ-ve të organizuara nga OSBE-ODIHR-i

² Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Rregulloren e Kuvendit

³ Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” .

funksioneve të tij.

- **Dialogu**

Dialogu është një proces i vazhdueshëm i konsultimit me publikun, i cili siguron shkëmbimin e pikëpamjeve për çështje të ndryshme në interes të palëve.

- **Partneriteti**

Partneriteti është forma më e ngushtë e bashkëpunimit me publikun, si përgjegjësi e përbashkët në çdo hap të procesit të vendimmarrjes.

4. Palët e interesuara

Palët e interesuara në kuptimin e këtij manuali, ndahen në dy kategori:

- **Palët e interesuara nga publiku** janë individë, ekspertë të pavarur, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit⁴, lobistë⁵ si dhe grupime të tjera të interesuara. Ata janë përfaqësuesit e qytetarëve (përfshirë edhe fëmijët e shoqëruar nga të rriturit), të cilët janë të prekur nga një ligj apo politikë e caktuar; organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e tyre; organizata të punëmarrësve; shoqata të bizneseve apo shoqata të ndryshme profesionale, etj.

- **Palët e interesuara nga institucionet publike** janë përfaqësues të institucioneve publike sipas legjisllacionit në fuqi.⁶ Në përcaktimin e palëve të interesuara nga institucionet publike dhe informacionit të kërkuar prej tyre, nga organet e Kuvendit mbahet parasysh parimi kushtetues i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

⁴ Idem neni 2, pika 4.

⁵ Vendim nr. 61/2018 për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

⁶ Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” neni 2, pika 9.

Kapitulli II

■ VEPRIMTARIA E KUVENDIT

Veprimtaria e Kuvendit është e hapur, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe, në kushtet e përcaktuara në Rregulloren e tij. Publiku gëzon të drejtën e njohjes me nismat, dokumentet, procesin dhe vendimmarrjen nga institucionet publike, pa qenë i detyruar të shpjegojë arsyet. Kuvendi krijon kushtet e duhura për ndërtimin e marrëdhënieve funksionale dhe ndërveprimin me publikun, si dhe intensifikimin e punës në drejtim të rritjes së perceptimit publik për një vendimmarrje sa më pranë qytetarit.

Publiku ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit⁷.

2.1. Agjenda parlamentare

Agjenda parlamentare e punimeve e informon publikun për veprimtarinë që kryen Kuvendi në ushtrim të funksioneve kushtetuese: ligjberëse, kontrolluese, zgjedhëse dhe përfaqësuese. Agjenda parlamentare përmban:

a) Programin e punës së Kuvendit⁸ për një periudhë nga 3 deri në 9 javë. Programi miratohet nga Konferenca e Kryetarëve dhe/ose Kuvendi në seancë plenare. Mbi bazën e këtij programi, komisionet parlamentare hartojnë programin e punës së tyre.

b) Kalendarin 3-javor i punimeve të Kuvendit⁹, miratohet nga Konferenca e Kryetarëve dhe/ose Kuvendi në seancë plenare. Mbi bazën e këtij kalendar, komisionet parlamentare hartojnë kalendarin e punës së tyre.

c) Rendi i ditës i seancës plenare¹⁰ dhe rendi i ditës i mbledhjes së komisioneve parlamentare (bazuar në kalendarët e punimeve) njoftohet dhe miratohet ditës e zhvillimit të mbledhjes së organit përkatës.

Komisionet e përhershme mund të miratojnë edhe kalendarë me afate të ndryshme për çështje të kontrollit parlamentar, që nuk përfshihen në programin e punës dhe në kalendarin e punimeve të Kuvendit.

Programi, kalendarin i punës dhe rendi i ditës së Kuvendit dhe komisioneve parlamentare publikohen në faqen zyrtare në internet, www.parlament.al.

2.2. Organet e Kuvendit

Organet e Kuvendit janë struktura vendimmarrëse ose këshillimore mbi të cilat është i organizuar dhe funksionon Kuvendi. Këto organe drejtojnë veprimtaritë funksionale dhe organizative të Kuvendit.

Organet e Kuvendit sipas Rregullores¹¹ janë:

- Byroja
- Sekretariatet
- Konferenca e Kryetarëve
- Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin
- Këshilli për Legjislacionin

⁷ Neni 3 i Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

⁸ Neni 26 i Rregullores së Kuvendit

⁹ Neni 27 i Rregullores së Kuvendit

¹⁰ Neni 27/1 i Rregullores së Kuvendit

¹¹ Nenet 5-15 të Rregullores së Kuvendit

- Grupet parlamentare
- Komisionet/nënkomisionet parlamentare
- Delegacionet e përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare

Informacioni i detajuar për përbërjen dhe veprimtarinë e organeve të Kuvendit publikohet në faqen zyrtare të internetit¹².

2.3. Deputeti dhe publiku

Palët e interesuara nga publiku kontaktojnë me deputetët, për të diskutuar me ta çështje të caktuara në interes të tyre. Deputeti në rast se mbështet mendimet dhe propozimet e palës së interesuar, ushtron të drejtën për të paraqitur nisma ligjore që ai mendon se janë me interes publik. Deputeti, në përmbushje të funksionit të tij, si përfaqësues i zgjedhësve, përdor edhe mekanizma të kontrollit parlamentar për të sjellë në Kuvend zërin e publikut, si:

- Pyetjet me shkrim¹³
- Interpelancat
- Mocionet

Informacioni për veprimtarinë e deputetëve, zyrat rajonale të deputetëve dhe “*si të kontaktosh deputetin tënd*”¹⁴

Komunikimi i rregullt me deputetët në zonat zgjedhore - Qytetarët mund të komunikojnë me deputetët që përfaqësojnë zonat e tyre zgjedhore, duke i kontaktuar direkt në postën elektronike zyrtare, të publikuar në faqen elektronike të Kuvendit, ose përmes zyrave të komunikimit të deputetëve me publikun në zonat zgjedhore. Për këtë qëllim shërben “*Java e gjelbër*”¹⁵, e cila zhvillohet në javën e katërt kalendarike të programimit mujor të veprimtarisë parlamentare dhe organizohet nga deputetët dhe grupet parlamentare për njohjen e zgjedhësve me punimet e Kuvendit dhe trajtimin e problemeve të tyre.

2.4. Mjetet dhe platforma

Për qëllimin e këtij manuali, si dhe për t’i shërbyer sa më mirë qasjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit, informacioni që ofrohet është ndarë në disa kategori të cilat vijojnë më poshtë:

2.4.1. Programi i transparencës¹⁶

Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit

Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit ndjek dhe mbikëqyr punën e shërbimeve të Kuvendit, të ngarkuara për garantimin e transparencës së veprimtarisë së deputetëve, komisioneve e shërbimeve të Kuvendit ndaj publikut dhe institucioneve. Sekretariati mbikëqyr punën për aplikimin e përdorimit të teknologjive të përparuara të informacionit (*e-parlament*), për modernizimin e funksioneve të shërbimeve që ofron administrata, si dhe për mbështetjen e monitorimit të veprimtarisë së institucioneve kushtetuese të pavarura e atyre të krijuara me ligj. Sekretariati mbikëqyr, gjithashtu, punën për informimin e publikut në veprimtarinë e Kuvendit dhe institucioneve kushtetuese të pavarura e atyre të krijuara me ligj.

Programi i transparencës për Kuvendin është hartuar dhe publikuar në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe shërben për të lehtësuar informimin e publikut. Informacioni i publikuar në këtë program synon të bëjë transparencë për veprimtarinë e punës së Kuvendit përmes paraqitjes së detajuar dhe lehtësisht të kuptueshme të përmbajtjes së tij në faqen

¹² www.parlament.al

¹³ Nenet 89 – 99 të Rregullores

¹⁴ www.parlament.al/Anetar/AllAnetar

¹⁵ Neni 40/1 i Rregullores

¹⁶ Programi i transparencës: <https://www.parlament.al/Informacion/Transparenca/4>

zyrtare të internetit të Kuvendit www.parlament.al, si dhe përmes paraqitjes në mjediset e pritjes së publikut. Nëse informacioni nuk është në programin e transparencës, formulari i kërkesës shkarkohet nga faqja elektronike e Kuvendit, plotësohet me kërkesën përkatëse dhe dërgohet në adresë të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit¹⁷ (KDI).

2.4.2. Kërkesa për informim

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë në adresë të institucionit ose me *e-mail* në adresën e KDI. Në çdo rast kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, i cili është *on-line*¹⁸. Sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dërgimi i kërkesës për informim¹⁹ me postë elektronike kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar.

2.4.3. Kuvendi, publiku dhe media

Një nga mënyrat me të cilat Kuvendi i qaset publikut është nëpërmjet medias pamore dhe të shkruar. Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) ka të drejtën ekskluzive dhe detyrimin e transmetimit të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së Kuvendit. Mediet e tjera mund ta marrin sinjalin e transmetimit nga RTSH. Mediet audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja, si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë kanë të drejtën e akreditimit²⁰ pranë institucionit të Kuvendit.

Televizioni Publik Shqiptar, konkretisht kanali i kushtuar Kuvendit (RTSH-Kuvend), transmeton video/spote informuese për publikun e gjerë, ku paraqitet informacion i hollësishëm për veprimtarinë e Kuvendit (*seanca plenare dhe komisione*) dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në veprimtarinë parlamentare.

Televizioni Publik Shqiptar, (RTSH Kuvend) transmeton në gjuhën e shenjave seancën plenare, sipas një protokollit të përcaktuar në marrëveshjen midis Kuvendit, Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD).

Media dhe publiku mund të ndjekin mbledhjet e komisioneve parlamentare nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Kuvendit, faqes zyrtare në rrjetin social “Facebook” dhe në kanalën e kushtuar në “Youtube”. Njoftimet për të ndjekur veprimtarinë e përditshme të Kuvendit publikohen në rubrikën “Aktualitet”.

Të pranishmit në mjediset e Kryesisë së Kuvendit dhe në sallën e seancave plenare kanë mundësinë të marrin një informacion elektronik, orientues, të përditësuar dhe transparent përmes disa pikave *Info Point* të vendosura respektivisht në këto mjedise.

Ky sistem informativ përmban ndër të tjera informacionet kryesore për vendin, orën, rendin e ditës së punimeve në seancë plenare, në komisionet parlamentare, por edhe për sa u përket veprimtarive të tjera parlamentare.

2.4.4. Aplikacioni mobile “Kuvendi i Shqipërisë”

Aplikacioni “Kuvendi i Shqipërisë” është një mjet për publikun për të marrë informacion në kohë reale për veprimtarinë e Kuvendit përmes një pajisjeje *smart phone*.

Aplikacioni është publik në dy *marketet on line* “Google Play” (Android) dhe “App Store” (IOS), të cilat mund të shkarkohen pa pagesë.

Aplikacioni mobile i Kuvendit në seksionin “Live stream” ofron mundësinë për të ndjekur drejtpërsëdrejti seancat parlamentare.

¹⁷Koordinatori informimit: <https://www.parlament.al/Informacion/Transparenca/73>

¹⁸ Regjistrin e gjeni në këtë link: <https://www.parlament.al/Informacion/Transparenca/6>

¹⁹ Formularin “Kërkesë për informim”, e gjeni në linkun: <https://www.parlament.al/aplikime/>

²⁰Vendim nr. 86, datë 06.07.2021. “Për Disa Ndryshime në Rregulloren për Akreditimin, Akomodimin dhe Orientimin e Masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë” (parlament.al)

Në seksionin “Rendi i ditës” ka mundësi për marrje informacioni për veprimtarinë , tematikat dhe mbledhjet që do të kryhen në data të caktuara.

Në seksionin “Lajme” merret informacion mbi lajmeve më të fundit për projektligjet e miratuara si në Komisionet Parlamentare ashtu edhe në Seancën Plenare.

Merret informacion gjithastu, për veprimtarinë parlamentare në tërësi sipas agjendës të organeve të Kuvendit.

Për të lehtësuar kontrollin për filtrimin e lajmeve, sipas strukturës, është krijuar një *drop down list*, ku mund të zgjidhni një strukturë, sipas së cilës do të shfaqen lajmet relativisht të lidhura me këtë strukturë.

Për të parë më shumë rreth një lajmi shtypet mbi butonin “Më shumë”, i ndodhur në të djathtë të çdo lajmi.

Me lundrimin e seksionit “Aktet” gjendet informacioni për aktet ligjore.

Hyrja në aplikacion kërkon vendosjen e kredencialeve personale (identifikimin e personit dhe fjalëkalimin). Lundrimi i mëtejshëm mundëson *live streaming*.

Kapitulli III

■ BASHKËPUNIMI I KUVENDIT ME PUBLIKUN

Kuvendi ka disa mekanizma, që u mundësojnë qytetarëve pjesëmarrjen në veprimtarinë e tij gjatë ushtrimit të funksioneve kushtetuese²¹.

Veprimtaria e Kuvendit konsiston kryesisht, por jo vetëm, në tre funksione parësore:

- a) Funksionin ligjbërës;
- b) Funksionin kontrollues e mbikëqyrës.
- c) Funksioni zgjedhës

3.1. Propozimi i nismave legjislative

E drejta për të propozuar projektligje, përveç Këshillit të Ministrave dhe çdo deputeti, i takon edhe 20 mijë zgjedhësve (procedura është e parashikuar në një ligj të veçantë).²² Projektligji hartohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për hartimin e projektakteve dhe konsultimin e tyre²³. Kuvendi, në procesin e nismave legjislative, mund të organizojë seanca dëgjimore publike²⁴, të ftojë palët e interesuara në seancë dëgjimore sipas parimeve të procesit të koordinimit të pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik.

Nismat ligjbërëse - Kushtetuta i jep mundësinë **20 mijë zgjedhësve**²⁵ që të propozojnë projektligje, të cilat, nëse respektojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për nismat ligjvënëse të shtetasve, bëhen pjesë e agjendës parlamentare dhe shqyrtohen në Kuvend.²⁶

Peticionet - Kushtetuta i garanton publikut të drejtën për t'u dërguar kërkesa institucioneve publike, ku këto të fundit kanë detyrimin të përgjigjen brenda një afati ligjor.²⁷ Nëpërmjet peticioneve publiku adreson problematika që duan t'i paraqesin për zgjidhje pranë Kuvendit.²⁸

Komentet dhe rekomandimet - palët e interesuara kanë të drejtë të dërgojnë komente dhe/ose rekomandime për aktet ligjore që shqyrtohen në Kuvend, që nga momenti kur ato i njoftohen publikut dhe publikohen në faqen zyrtare. Palët e interesuara mund t'i dërgojnë komentet dhe/ose rekomandimet për projektaktet në adresë të koordinatorit për grupet e interesit ose në adresë të komisionit. Një formë tjetër e dërgimit të komenteve dhe/ose rekomandimeve është nëpërmjet platformës *online* të konsultimit të projektligjeve, e cila aksesohet në faqen zyrtare të Kuvendit.²⁹ Komentet dhe rekomandimet duhet të kenë formën e amendamentit sipas teknikës legjislative

3.2. Seancat dëgjimore

Seanca dëgjimore publike është mekanizmi me anë të të cilit Kuvendi, brenda fushës së vet të përgjegjësisë, ushtron kontrollin parlamentar për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe të politikave të ndryshme.

²¹ <http://parlamerica.org/uploads/documents/Roadmap-EN-SCREEN.pdf>

²² Ligji 54/2019 "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë"

²³ Ligji Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

²⁴ Neni 36 i Rregullores së Kuvendit

²⁵ Neni 81 Kushtetutës

²⁶ Neni 68 i Rregullores së Kuvendit

²⁷ Kushtetuta, neni 48.

²⁸ Rregullorja e Kuvendit, neni 104.

²⁹ www.parlament.al

Gjatë procesit të hartimit të kalendarit komisioni vlerëson mundësinë e zhvillimit të seancave dëgjimore publike³⁰ për procesin legjislativ dhe kontrollin parlamentar.

Seancat dëgjimore janë të hapura për publikun me përjashtim të rasteve kur komisioni vendos ndryshe.³¹

Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.

Palët e interesuara në lidhje me çështjen në diskutim mund të paraqesin pozicionin e tyre në komision.

3.2.1. Seancat dëgjimore në procesin legjislativ

Seancat dëgjimore për procesin legjislativ kanë objekt marrjen e mendimeve dhe rekomandimeve gjatë shqyrtimit të një projektligji.³²

Gjatë fazës së shqyrtimit, publiku jep kontributin e tij përmes platformës, sekretarisë së komisionit dhe/ose Koordinatorit për Grupet e Interesit (KGI).

Me përfundimin e afatit të përcaktuar nga struktura/organi për paraqitjen e rekomandimeve, komisioni mbyll procesin e konsultimit për projektligjin në fjalë dhe vazhdon shqyrtimin e tij në fazat e tjera të procesit legjislativ.

3.2.2. Seancat dëgjimore, kontroll parlamentar

Seancat dëgjimore për procesin e kontrollit parlamentar kanë objekt marrjen e shpjegimeve dhe sqarime nga subjektet kompetente për fushën në objekt shqyrtimi.

Rregullorja e Kuvendit përcakton³³ se komisioni organizon seanca dëgjimore publike me palët e interesuara.

Seancat dëgjimore për kontrollin parlamentar zhvillohen kryesisht në mjediset e Kuvendit, por, referuar ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit,³⁴ ato mbahen edhe jashtë selisë së Kuvendit.

Palët e interesuara mund të marrin informacion nëpërmjet dokumenteve të prodhuara nga organi përkatës.

Procesverbali i seancës dëgjimore publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit menjëherë pas miratimit të tij në mbledhjen pasardhëse.³⁵

3.2.3. Seancat dëgjimore, procesi zgjedhës

Referuar bashkëpunimit në funksionin zgjedhës, Shoqëria civile merr pjesë drejtpërdrejtë nëpërmjet kandidaturave të propozuara nga kjo e fundit për vendet vakante të krijuara në Institucionet e Pavarura Kushtetuese e ato të krijuar me ligj të cilat zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë e konkretisht:

a) 6 anëtarë të Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) propozohen nga shoqëria civile;
b) 10 anëtarë të Bordit të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar (KDRTSH) propozohen nga shoqëria civile;

c) 1 anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) propozohet nga shoqëria civile;

d) 1 anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) propozohet nga shoqëria civile;

e) 1 anëtar në Këshillin e Institutit të Statistikave (INSTAT) propozohet nga shoqëria civile;

f) 1 anëtar në Bordin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) propozohet nga shoqëria civile;

g) 2 anëtarë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) propozohen nga shoqëria civile.

³⁰ Neni 36 i Rregullores së Kuvendit .

³¹ Neni 35 i Rregullores së Kuvendit.

³² Neni 36 i Rregullores së Kuvendit

³³ Neni 36 i Rregullores së Kuvendit.

³⁴ Neni a/4 36 i Rregullores së Kuvendit.

³⁵ Neni 39 i Rregullores së Kuvendit.

3.2.4. Kërkesa dhe **koordinimi** për pjesëmarrje

Kalendari i Kuvendit dhe Kalendarët e punimeve të komisioneve të përhershme publikohen në faqen e internetit të Kuvendit. Palët e interesuara njihen me çështjet që do të trajtojnë komisionet gjatë tri javëve në vijim. Nëse palët e interesuara vërejnë se ndonjë nga komisionet do të zhvillojë një seancë dëgjimore publike me rëndësi për to, atëherë ato mund të shprehin interesin për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore.

Shprehja e interesit për pjesëmarrje bëhet nëpërmjet Koordinatorit të Grupeve të Interesit (KGI) dhe duhet të paraqitet në formën e një kërkesë (shih aneksin) në adresën postare apo elektronike të Kuvendit dhe adresën e KGI.

KGI, në bashkëpunim me organet e Kuvendit, koordinon të gjithë procesin e pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit, me të gjitha mjetet e aksesueshme të komunikimit.

Kërkesa për pjesëmarrje:

- Për palët e interesuara që janë të regjistruar pranë Kuvendit, (shih regjistrat).
- Për publikun sipas formularit bashkëlidhur (aneksi).

Sa më sipër, pas marrjes së kërkesës, komisioni vendos për listën e të ftuarve³⁶.

3.3. Platforma e konsultimit *online* të projektligjeve

Kuvendi, ka në dispozicion gjithashtu platformën *on-line* të konsultimit publik të akteve ligjore. Platforma ofron mundësinë e konsultimit *online* të projektligjeve <http://konsultimi.parlament.al>.

Komisionet parlamentare, pas miratimit të kalendarëve të punës dhe caktimit të akteve që do t'i nënshtrohen konsultimit me palët e interesuara, përdorin platformën *online* për të publikuar aktet për të cilat kërkohet mendimi dhe opinioni i publikut.

Aktet publikohen në platformën *online* për një periudhë të caktuar sipas afateve procedurale të shqyrtimit të projektakteve. Në momentin e publikimit të projektaktit *online* koordinatori për grupet e interesit, në bashkëpunim me sekretarinë e komisionit përgjegjës, automatikisht njofton të gjitha palët e interesuara të regjistruara në regjistrin *online* të OSHC-ve dhe në regjistrin e lobistëve që janë në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Me mbarimin e afatit të konsultimit *online* sekretaria e komisionit përgjegjës përfton të dhënat nga platforma dhe i vendos edhe në dispozicion të komisioneve për dhënie mendimi. Pas mbledhjes dhe përpunimit të komenteve dhe sugjerimeve të publikuara në platformë, komisionet kanë të drejtë që të organizojnë edhe seanca dëgjimore.

Publiku komenton projektaktin e publikuar për konsultim publik në bllok (në fund ose përbri) ose nen për nen.

Raporti i komisionit përmban një pikë më vete për konsultimin publik³⁷/seancë dëgjimore në të cilën komisioni ka detyrimin të raportojë për mbledhjet e komisionit me grupet e interesit dhe/apo shoqërisë civile, të paraqesë në mënyrë të përmbledhur opinionet/sugjerimet/prendimet e grupeve të interesit dhe/apo shoqërisë civile dhe sa prej tyre janë pranuar nga komisionet.

Në përfundim të procesit të konsultimit/seancë dëgjimore dhe pas miratimit të aktit nga Kuvendi, koordinatori për grupet e interesit, në bashkëpunim me sekretarinë e komisionit/komisioneve, do të publikojë dhe pasqyrojë në një tabelë të vendosur në fund të projektaktit këto të dhëna:

- Numrin e palëve të interesuara të përfshira në proces;
- Numrin e opinionëve/komenteve të dhëna për projektin;
- Numrin e opinionëve të marra në konsideratë nga komisionet në përfundim të procesit të miratimit të aktit në komisionet respektive (duke referuar raportin e komisionit).

Këto të dhëna janë transparente për publikun. Platforma *on-line* e konsultimit rifreskohet çdo sesion parlamentar (dy herë në vit: janar dhe korrik).

³⁶ Nenet 32 dhe 33 të Rregullores së Kuvendit

³⁷ Urdhër nr. 29, datë 29.01.2019, "Për standardizimin e formatit të raportit të komisioneve për projektligjet".

Kapitulli IV

■ KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PUBLIKU

Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE) është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian³⁸.

Misioni parësor i KKIE është nxitja dhe garantimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe sigurimi i rritjes së transparencës në vendimmarrjet për çështjet e integritit. KKIE organizohet dhe funksionon sipas ligjit³⁹ dhe rregullores së tij⁴⁰.

Të gjitha takimet e KKIE-së transmetohen *drejtpërdrejt* në media, në faqen e Kuvendit si dhe në *mediën sociale* (Facebook të Kuvendit dhe KKIE).

KKIE është një mekanizëm institucional i konsultimit për çështjeve të integritit europian me të gjithë aktorët e interesuar, në të cilin shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm. KKIE, duke vlerësuar ekspertizën dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile në çështjet e integritit europian, organizon në bashkëpunim me to veprimtari ndërgjegjësuere apo informuese për çështje të ndryshme për integrimin europian.

Kapitulli V

■ PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VEPRIMTARI TË TJERA

Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në promovimin e pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e tij nëpërmjet programeve që ofrohen në kuadrin e edukimit qytetar si:

- “*Dita e Dyerve të Hapura*”, ku çdo qytetar i interesuar ftohet të vizitojë ambientet e Kuvendit;
- Loja “*Këndvështrimi im*”⁴¹, e cila ka për synim edukimin e fëmijëve dhe të rinjve me debatin publik dhe për të qenë qytetarë aktiv të shoqërisë;
- Publikimin në faqen e Kuvendit i “*Turit virtual*”⁴² për Sallën e Seancave Plenare dhe Kryesinë e Kuvendit;
- Pyetësori “*Kuvendi në pëllëmbë të dorës*”⁴³, i cili vjen në formën e një loje, i hapur për t’u plotësuar nga cilido që ka interesin dhe njohuritë minimale mbi Parlamentarizmin
- Programet e praktikave parlamentare për studentët, janë disa prej veprimtarive që organizohen për të afruar dhe njohur publikun me funksionet dhe veprimtarinë e tij, pasi të rinjtë janë kategoria e cila gëzon një vëmendje të veçantë dhe në këtë kuadër Kuvendi ka iniciuar nënshkrimin e një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitetet publike dhe private⁴⁴.

5.1. Pjesëmarrja e publikut në Kuvend

Ndjekja e mbledhjeve të komisioneve dhe seancave plenare

Publiku ka të drejtën dhe mund të ndjekë mbledhjet e komisioneve dhe seancave plenare *online* ose me prani fizike. Kjo mundësohet duke aplikuar në formularin përkatës (sipas aneksit X) në adresë të KDI⁴⁵, të paktën 7 ditë përpara datës së seancës plenare, për ndjekjen drejtpërdrejt të zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve ose seancave plenare.

Pjesëmarrja e publikut është e kushtëzuar nga numri i vendeve të disponueshme në *galerinë* për publikun.

5.2. Vizitat në Kuvend dhe pjesëmarrja në programet e edukimit qytetar

Qytetarët vizitojnë godinën e Kuvendit dhe marrin pjesë në guidat që organizon Shërbimi për Pritjen e Publikut. Ata ndjekin zhvillimin e seancave plenare nga *Galeria* për publikun në sallën e seancave plenare, me përjashtim të rastit të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit. Instituti Parlamentar (IP) është një shërbim i veçantë në administratën e Kuvendit, në mbështetje të deputetëve në ushtrimin e funksioneve të tyre përfaqësuese, ligjberëse, dhe mbikëqyrëse. Instituti ka si qëllim të mbështesë vendimmarrje të mirë-informuar përmes ofrimit të informacionit dhe produkteve kërkimore, si edhe zbatimit të programeve të edukimit qytetar, krijon dhe zbaton programe të cilat informojnë dhe edukojnë qytetarët në lidhje me demokracinë dhe qeverisjen, si edhe nxit qytetarët të jenë aktiv në punën e Kuvendit.

³⁸ Ligjit nr. 15/2015, datë 05.03.2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”.

³⁹ Ibidem

⁴⁰ Vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 67, datë 04.05.2016.

⁴¹ Lojën “Këndvështrimi im” e gjeni në linkun: <https://www.parlament.al/Neës/Index/15147>

⁴² Turin Virtual e gjeni në linkun: <https://www.parlament.al/News/Index/11602>

⁴³ Lojën “Kuvendi në pëllëmbë të dorës” e gjeni në linkun: <https://www.parlament.al/News/Index/15148>

⁴⁴ www.parlament.al/Strukture?kategori=1002&strukture=1042

⁴⁵ Koordinator i informimit: <https://www.parlament.al/Informacion/Transparenca/73>

5.3. Raporti periodik dhe konferenca vjetore

Kuvendi harton raporte periodike “Për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit” të cilat pasi miratohen në Byronë e Kuvendit, publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.

Kuvendi mund edhe të organizojë konferencë vjetore për çështje të bashkëpunimit me publikun.

Kapitulli VI

■ REGJISTRAT DHE FORMULARËT

Në faqen elektronike të Kuvendit janë të publikuar regjistrat elektronikë për shoqërinë civile, lobistët, peticionet dhe kërkesat për informim. Në faqen zyrtare gjenden edhe formularët *on-line*, kërkesë për pjesëmarrje në veprimtarinë e komisioneve dhe seancave dëgjimore.

6.1. Regjistri për shoqërinë civile⁴⁶

Regjistri është një mjet për identifikimin e organizatave jofitimprurese dhe shërben si mjet lidhës dhe komunikues me Kuvendin. Ai është i ndarë në bazë të fushave të përgjegjësisë së komisioneve të përhershme parlamentare. Regjistri përditësohet periodikisht në bazë të kërkesave të organizatave, që shprehin vullnetin e tyre për të qenë pjesë e veprimtarisë së Kuvendit.

6.2. Regjistri për lobistët⁴⁷

Në Kuvend është krijuar regjistri për lobistët që mbajnë marrëdhënie me deputetin dhe komisionet parlamentare. Ai është i ndarë në bazë të fushave të përgjegjësisë së komisioneve të përhershme parlamentare. Regjistri përditësohet çdo fillim legjislature bazuar në thirrjen publike që Kuvendi u drejton grupeve lobiste që janë të interesuara të bashkëpunojnë me të.

6.3. Regjistri për peticionet⁴⁸

Regjistri i peticioneve përmban të gjitha të dhënat që Kuvendi ka për peticionet që i drejtohen Kuvendit, si dhe statusin e zhvillimit të tyre nga komisionet parlamentare. Peticioni depozitohet në Kuvend drejtuar Kryetarit të Kuvendit, i cili ia përcjell menjëherë për shqyrtim komisionit parlamentar. Administrata e komisionit parlamentar vlerëson nëse peticioni përmbush kriteret formale dhe materiale. Peticioni mund të kthehet te dërguesit për plotësim/rihartim. Kryetari i komisionit parlamentar e paraqet brenda 45 ditësh në komision dhe propozon zgjidhjen ligjore. Hapat e marrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur u njoftohen dërguesve të peticionit.

Komisioni parlamentar mund të vendosë dërgimin e peticionit edhe:

- Një komisioni tjetër parlamentar;
- Këshillit të Ministrave
- Avokatit të Popullit
- Institucioneve publike

Komisioni parlamentar mund të autorizojë Kryetarin e Komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancë plenare dhe në përfundim jep shpjegime me shkrim, merr një vendim ose propozon projektligj.

6.4. Regjistri i kërkesave për informacion

Në faqen e Kuvendit gjendet i publikuar edhe regjistri i përditësuar i kërkesave për informacion dhe përgjigjeve.⁴⁹

⁴⁶ www.parlament.al/Informacion/Transparenca/1

⁴⁷ www.parlament.al/Informacion/Transparenca/34

⁴⁸ Neni 104 i Rregullores së Kuvendit

⁴⁹ Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve: <https://www.parlament.al/Informacion/Transparenca/6>

Shtojca⁵⁰

■ SHPJEGUES I TERMINOLOGJISË SË MANUALIT

“**Aplikacion**” është mjet informimi i Kuvendit në platformat elektronike IOS dhe Android, në të cilën mund të merret informacion për veprimtarinë e Kuvendit nëpërmjet aparateve *smart phone*.

“**Ekspert**” është personi me njohuri të veçanta në një fushë të caktuar.

“**Grupe interesi**” janë subjekte fizike ose juridike që mund të preken nga miratimi i një projekti apo të interesuara për një çështje të caktuar, përfshirë këtu edhe organizatat e punëmarrësve ose të biznesit.

“**Grupime të tjera të interesuara**” janë grupimet e individëve, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë për një çështje të veçantë me në një moment të caktuar.

“**Koalicione**” janë grupimi i disa organizatave jofitimprurëse, që kanë qëllime të përbashkëta dhe bashkërendojnë veprimet në një fushë të caktuar.

“**Koordinator për të drejtën e informimit**” (KDI) është nëpunësi civil i përcaktuar në nenin 10 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

“**Koordinator me grupet e interesit (KGI)**” Koordinatori për grupet e interesit është struktura institucionale, që merret me koordinimin e marrëdhënieve dhe lehtësimin e praktikave të bashkëpunimit midis Kuvendit dhe palëve të interesuara.

“**Konsultim publik /seancë dëgjimore**” është mekanizmi me anë të cilit çdo komision parlamentar, brenda fushës së vet të përgjegjësisë, lejon marrjen e informacionit nga palët e interesuara.

“**Organizata jofitimprurëse**” janë shoqatat, fondacionet dhe qendrat veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti dhe veprojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse, në kuptim të këtij manuali, përfaqësojnë interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë.

“**Palët e interesuara**” në procesin e njoftimit e të konsultimit publik janë: a) organet publike; b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; c) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

“**Publik**” janë subjektet që ndërveprojnë me Kuvendin në shprehje të interesave të tyre. Ato ndahen si; qytetari/individ, lobistët, organizatat e shoqërisë civile, grupe të interesit etj.

“**Lobistët**”⁵¹ janë subjekte fizike apo juridike që kryejnë veprimtari pranë organeve shtetërore, në rastin konkret Kuvendit për të ndikuar vendimmarrjen.

“**Shoqëri civile**” sipas përkufizimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, janë organizatat vullnetare të qytetarëve, të cilat kanë si qëllim përparimin e ideve, interesave dhe ideologjive të tyre. Në këtë kuptim shoqëria civile njësohet me organizatat jofitimprurëse.

⁵⁰ Përpunimi i të dhënave bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

⁵¹ Vendim nr. 61/2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”



KËRKESË PER NDJEKJEN E VEPRIMTARIVE TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Tiranë më _____

EMËRTIMI I PLOTË I SUBJEKTIT:

(nëse kërkesa vjen në emër të subjektit)

*NIPT/KODI FISKAL: JO PO Cilësoje _____

ÇËSHTJA PËR TË CILËN

KËRKOHET

PJESËMARRJA:

Komisioni _____ Data _____ Ora _____

ARSYEJA E PJESËMARRJES:

PERSONAT PJËSMARRËS:

(në rastin e listës shumëemërore të shtohen në mënyrë rendore të dhënat për çdo person)

1. Emri _____ Adresa _____

Mbiemri _____ E-Mail _____ Tel _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti Numri _____

2. Emri _____ Adresa _____

Mbiemri _____ E-Mail _____ Tel _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti Numri _____

Dokumente të tjera:

(opsionale/nëse argumentojnë pjesëmarrjen)

Nënshkrimi: (Emër/Mbiemër/Vula)

*opsionale



FORMULAR REGJISTRIMI NE REGJISTRIN ON-LINE TE OSHC-VE

Tiranë më _____

1. EMËRTIMI I PLOTË I SUBJEKTIT: _____

NIPT: ose **Kodi Fiskal** _____

STATUSI:

Person Fizik Person Juridik

2. FUSHA E VEPRIMTARISË _____

3. KONTAKTE

Administratori: _____

Adresa: _____

Qyteti/Komuna: _____

Nr. Tel: _____

E-Mail: _____

3. TË DHËNAT E PERSONIT TË KONTAKTIT PËR KUVENDIN

Emri _____ **Adresa** _____

Mbiemri _____ **E-Mail** _____ **Tel** _____

Dokument identifikues: Pasaportë Kartë Identiteti

Numri i dokumentit identifikues _____ / Data e lëshimit _____

Nënshkrimi (Emër/Mbiemër/Vula) _____



KËRKESË PËR PJESËMARRJE NË SEANCAT DËGJIMORE TË KOMISIONEVE

Tiranë më _____

EMËRTIMI I PLOTË I SUBJEKTIT: _____

*NIPT/KODI FISKAL: JO PO Cilësoje _____

FUSHA E VEPRIMTARISË _____

ÇËSHTJA PËR TË CILËN KËRKOHET PJESËMARRJA: _____

Komisioni _____ Data _____ Ora _____

ARSYEJA E PJESËMARRJES: _____

PERSONAT PJESËMARRËS:

(në rastin e listës shumëëmërore të shtohen në mënyrë rendore të dhënat për çdo person)

1. **Emri** _____ **Adresa** _____

Mbiemri _____ **E-Mail** _____ **Tel** _____

Mashkull **Femër** **Nuk dëshiroj të shprehem**

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti **Numri** _____

2. **Emri** _____ **Adresa** _____

Mbiemri _____ **E-Mail** _____ **Tel** _____

Dokument identifikues Pasaportë Kartë Identiteti **Numri** _____

Dokumente të tjera:

(opsionale/nëse argumentojnë pjesëmarrjen)

Nënshkrimi: (Emër/Mbiemër/Vula)

*Opsionale|

